



Muzeu i Librazhdit / Librazhd Museum

Është një muze i kategorisë së parë dhe mbanë në vetvete vlera të jashtëzakonshme kulturore. Ky muze për vite me radhë është cilësuar si një muze model.

Librazhd Museum is a first category museum and it contains extraordinary cultural value. For years and years this museum was declared as museum model.

Muzeut Etnografik

Krahina e Librazhdit ka trashëguar nga e kaluara e saj e larmishme një kulturë të gjerë etnografike që mbi bazën e kulturës kombëtare është zhvilluar e pasuruar gjatë shekujve që sot

përfaqëson kulturën etnografike të krahinës së Librazhdit.

Në mjedisin e këtij muzeu paraqitet jeta ekonomike e popullsisë së vendit e zhvilluar në bazë të kushteve jetësore klimatike dhe vendosjes së vendbanimeve. Një vend të rëndësishëm zenë mjediset familjare si konaku i miqve që pasqyron traditën e mirë të mikpritjes dhe shtëpia e bukës. Në këtë mjedis janë të vendosur objektet karakteristike të banesës fshatare. Treva e Librazhdit ndodhet në një pozitë gjeografike shumë të favorshme për zhvillimin e mjeshtërive të ndryshme si p.sh. përpunimi i gurit, drurit, metalit etj. Duke qenë një vend me pasuri të shumta natyrore në këtë krahinë ushtroheshin mjeshtëri të ndryshme si ajo e përpunimit të gurit, të drurit, të ndërtimit të banesave të metalit, të tekstilit etj. Disa nga prodhimet dhe mjetet e punës të këtyre mjeshtërive janë vendosur në mjediset e vecanta të muzeut.



Zakonet e mira këngët dhe vallet kostumet e bukura të stolisura me mjeshtëri flasin për një kulturë etnografike të pasur të kësaj krahine. Të tërheq vëmendjen maketi i shtëpisë me teliz të Cermenikës, theksoret e Polisit, rozetat e bukura të tavaneve, konaku i miqve të shtruar bukur me pajisje përkatëse, seria ezileve, gorriku për të pjekur bukë dhe shumë eksponente interesante.



138



139



140



141



Etnographic Museum

Librazhdi province has inherited from its past a wide variety of ethnographic culture that on the basis of national culture is developed and enriched over the centuries that today represents ethnographic culture of Librazhdi province. In the museum environment there is presented this economic life of the population of the country developed on the basis of climatic living conditions and establishment of houses.

An important place is occupied by family environments as “Konaku” of friends that reflects the best tradition of hospitality and the bread house. In this environment, there are set the characteristic objects of a village house. Territories of Librazhdi are in a very favorable geographical position for development of various artistry such as processing stone, metal, wood etc. As an area with abundant natural wealth of this province there were practiced handicrafts like stone processing timber building housing, metal, textile etc. Some of the work products and tools of these artifacts are placed in the specific areas in the museum.



Good habits, dances, songs and beautiful artistry adorned costumes speak for a rich ethnographic culture of this region. It is drawn attention to the model of the house with teliz of Cermenika, emphasis of Polis, the most beautiful ceiling rosettes of “Konak” nicely paved proper equipment, series of bells, “gorriku” relevant to loaf baking and very interesting exponents.



159. Nishit e kullmbathesit dhe e shetqarit ne rruget e Cermenikes. Fillimi i shek. XX.
160. Fardier and nomad dress along Cermenika roads, beginning of XX century.
161. Veshje e gruas se Qorishites. Cermenike. Fillimi i shek. XX.
162. Veshje e gruas se Qorishites. Cermenike. Fillimi i shek. XX.

PIKA TURISTIKE

■ *Meshtenka e Qarrishtes/ Birch of Qarrishta*

Ndodhet në fshatin Qarrishtë të rrethit të Librazhdit.

Ky monument ndodhet në Parkun Kombëtar “Shebenik-Jabllanicë”. Lartësia mbi nivelin e detit arrin në 1228m, me koordinatat (veri, jug): X=454522.5; Y=4567055.8;

Lartësia mesatare e drurëve është 12m, mosha 60 vjet. Monumenti i natyrës ka vlera të larta peisazhore, me vlera ekologjike e studimore. Rruga nëpërmjet të cilës mund të arrihet është rruga auto Librazhd-Qarrishtë (Fusha e zezë) 35 km. Rruga këmbësore është 0.5 km në drejtimin jugor të rrugës automobilistike.

Is set in Qarrishte Village of Librazhd Village. This monument is part of Shebenik- Jabllanice National Park. Height over sea level reaches 1228m, with coordinates (north, south): X=454522.5; Y=4567055.8;

Average height of the trees is 12 m, 60 years old. This natural monument has high landscape values and research or ecological values. To get there you have to follow the car road Librazhd -Qarrishte 35 km. The walking pathway is 0.5 km southward of the auto road.



■ *Shpella e Hasanit / Hasan Cave*

Ndodhet në afërsi të fshatit Dardhë e Malit, në lartësinë 930m mbi nivelin e detit. Është e formuar në shkëmbinjtë gëlqerorë të Kretës së sipërme. Është e gjatë rreth 43m, e gjerë rreth 1m dhe e lartë 4m. Është e mbushur me forma të shumta stalaktitesh e stalagmites.

Vizitohen sipas intinerarit Librazhd – Dardhë e Malit – monumenti

Situated near the village of Dardhe e Malit, up to 930 m above sea level. It is formed limestone cliffs of above Crete's. It is about 43m, a with of 1m and 4m high. it's filled with numerous formsof stalactites and stalagmites.

It can be visited by Librazhd –Dardhe e Malit itinerary - monument



■ *Kisha e Koshorishtit (Shpella Kishe), Shpella Eremite*

Kisha Eremite e Koshorishtit, një vlerë dhe një monument kulture i veçantë në llojin e saj, mendohet të jetë një krijim i shekullit të IX-XII të erës sonë, një vlerë unike dhe historike. Kjo shpellë kishë është e vendosur në një shkëmb në lartësi rreth 70 metra nga niveli i lumit të Qarrishtës ku janë pikturuar Maria dhe dishepujt gjatë një cerimonie. Shumë i rëndësishëm fakti që ngjyrat nuk kanë humbur prej asaj kohe. Shumë nga banorët e këtyre zonave shkojnë për ta vizituar si një vend i shenjtë që ju sjell fat, gjithashtu ka shumë vizitorë të tjerë dhe turistë vendas dhe të huaj që ngelin të mahnitur nga bukuria e saj.



❖ *Koshorishtit Church (Church cave), the Hermit Cave*

Koshorisht Hermit's Church, a monument value and a culture unique in its kind, believed to be a creation of the IX-XII century AD, a unique value and historical. This cave church is located on a cliff in height about 70 meters from the river of Qarrishta where Mary and the disciples were painted during a ceremony. Very important fact are the colors have not lost since a lot of time. Many of the residents of these areas go to visit a shrine that brings you luck, also has many other visitors and local and foreign tourists who remain captivated by its beauty.



■ *Shpella e Shkëmbit të Bletës / Bee Rock Cave*

Ndodhet në veriperëndim të fshatit Dardhë e Malit të rrethit të Librazhdit, në shpatin lindor të malit të Polisit dhe në rrëpirën shkëmbore të shkëmbit të Bletës me lartësi 1409m, është eksploruar nga speleologët e “Puglia Grotte” dhe “Dauno”. Për të vajtur tek kjo shpellë duhet të merret rruga automobilistike Librazhd - Dardhë dhe të vazhdohet më këmbë drejt shpatit lindor të Polisit

Located northwest of the village of Monte Pear Librazhdit district, on the eastern slope of Mount Polis and rocky ravine Bee Rock with height 1409m, is explored by speleologists the "Grotte Puglia" and "Dauno. To go to this cave you should talk the road Librazhd - Dardhe and than continue on foot towards the eastern slope of Polis.



■ *Shpella e Malit të Letmit (Shpella e Akullit) / Letem Mountain Cave (The Ice Cave)*

Kjo shpellë ndodhet në afërsi të malit me të njëjtin emër, në lartësinë 800m mbi nivelin e detit. Ajo është e formuar në shkëmbinjtë gëlqerorë të Triasit të sipërm - Jurës së poshtme. Është e gjatë rreth 60m, e gjerë rreth 7-8m. Është e mbushur me konkrecione të shumta stalaktitesh e stalagmites. Vizitohen sipas intinerarit Librazhd – Letmë – monumenti.




This cave is located near the mountain of the same name, at an altitude of 800m above sea level. It is formed in the limestone cliffs of the upper triast - the lower Juras.

It is about 60m long, a width of 7-8m. Filled with numerous concretions of stalactites and stalagmites. Visited by Librazhd–Letem itinerary – monument.

■ *Burimi i Studnës / Studen Spring*

Ky burim ndodhet në skajin lindor të fushës së Studnës, në lartësinë 600m mbi nivelin e detit. Përbën një burim të madh karstik, që del në kontaktin tektono-litologjik midis Triasit të sipërm dhe Flishit të vjetër. Ka ujë të shumtë, të pastër dhe të ftohtë. Ka vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike), kulturore didaktike dhe turistike. Vizitohen sipas itinerarit Librazhd – Studën.



This spring is located on the eastern edge of Studen field, up to 600m above sea level. It constitutes a great source of karst emerging on tektono-lithological contact between the upper Triasit and old Flysch. There is plenty of water, clean and cool. It has scientific value (geological, geomorphological, hydrological), didactic and cultural tourism. Visited by Librazhd – Studen itinerary.

■ *Gurra e Kosharishtit / Kosharist Fountain*

Kjo gurrë ndodhet në afërsi të fshatit Kosharisht, në lartësinë 600m mbi nivelin e detit. Përbën një burim të madh karstik që del në kontaktin tektono-litologjik midis gëlqerorëve të Triasit të sipërm - Jurës së poshtme dhe mollasave tortoniane. Ka ujë të shumtë, të pastër dhe të ftohtë.

This fountain is located near Kosharisht village, at the height of 600m above sea level. It contains a large source of karst arising in tektono-lithological contact between upper triasit limestone - the Lower Jurassic and Mollas tortonians. There is much water, clean and cool.



■ *Liqeni i Floqit / Floq Lake*

Ky liqen ndodhet në afërsi të fshatit Floq, në lartësinë 700m mbi nivelin e detit. Ai përbën një liqen të vogël karstik, të formuar në vendin e daljes së një burimi po karstik, që del në kontaktin tektoniko-litologjik midis gëlqerorëve të Kretës së sipërme dhe mollasave.



Vizitohen sipas itinerarit Librazhd – Floq.

This lake is located near Floq village, at the height of 700m above sea level. It forms a small karst lake, formed in the exit place of a karst source, which appears in tektonic-lithological contact between upper Cretaceous limestone and Mollas. Visited by Librazhd - Floq itinerary.

■ ***Liqeni i Shebenikut ose Cirqet dhe Liqenet Akullnajore Shebenik***

Ky liqen ndodhet në shpatin verior të Majës së Shebenikut, në lartësinë 1800m, i vendosur në një cirk të madh kompleks akullnajor. Këtu format glaciale janë shumë të zhvilluara. Ka ujë të pastër si kristali dhe të ftohtë. Gjatë dimrit ngrinë në sipërfaqe. Dallohet për botë të pasur të gjallë.



❖ ***Shebenik lake or Circuses and Shebenik Glacial Lakes***

This lake is located on the northern slope of Shebenik Peak, at 1800m altitude, situated in a large cirque glacial complex. Here glacial forms are developed. There are crystal-clear water and cool. During winter freezes on the surface. It stands for rich vibrant world.



■ *Liqeni i Varrit të Plakës / Plakes Grave Lake*

Liqeni i Varrit të Plakës ndodhet në fshatin Vehcan, në lartësinë 600m mbi nivelin e detit. Ai përbën një liqen të vogël karstik, i formuar në vendin e daljes së një burimi po karstik, që del në kontaktin tektonikolitologjik midis gëlqerorëve të Kretës së sipërme dhe mollasave. Vizitohen sipas itinerarit Librazhd – Vehcan.



Plakes grae Lake is located Vehcan village, at the height of 600m above sea level. it forms a small karstic lake, formed in the exit place of a karst source, which comes out of the tectonic-litologiccontact between the upper Crete limestone and Mollas. Visited by Librazhd-Vehcan itinerary.

■ *Rrepet e Gurakuqit / Gurakuq Maples*

Gjendet në qendër të fshatit Gurakuq në rrethin e Librazhdit. rreth 800 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson dy drurë rrapit të veçuar. Lartësia e drurëve është 15 – 16 m, diametri i trungjeve arrin në 220 – 230 cm, ndërsa mosha është 250 – 300 vjeçare. Rrepet janë ruajtur gjithnjë nga vetë banorët e fshatit Gurakuq, sepse kanë shërbyer si vendtakim për biseda, kuvende, etj. Kanë vlera shkencore (biologjike), didaktike, estetike, historiko – turistike, etj. Mund të vizitohen sipas rrugës rurale Librazhd – Gurakuq.

Found in the middle ofGurakuq village Librazhd district. About 800 m above sea level. It represents two separate maple trees. The height of the trees is 15-16 m, diameter of trunks reaches 220-230 cm, while age is 250-300 years. Maples are always saved by the villagers themselves of Gurakuq, because they serve as meeting venue for talks, assemblies, etc. Have scientific value (biological), didactic, aesthetic, historical - tourism, etc. They can be visited by the rural road Librazhd-Gurakuq.



■ *Rrapi i taksimit / Taksim Maple*

Ndodhet në afërsi të fshatit Librazhd Katund, në rrethin e Librazhdit, rreth 1000 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson një dru rrap i veçuar. Rrapi është i lartë rreth 10 m, ka 17 degë dhe perimetër të kurorës 16 m. Perimetri i trungut është rreth 180 cm, ndërsa diametri i tij është rreth 65 cm, një rrap 140-vjeçar në Lunik. Ka kurorë të bukur ombrellorë dhe druri është ruajtur mirë nga vetë banorët. Pranë tij janë mbledhur gjithnjë burrat e fshatit për takime e kuvende të rëndësishme. Ka vlera shkencore (biologjike), didaktike, estetike, kulturore dhe estetike. Mund të vizitohet sipas rrugës rurale Librazhd – Librazhd Katund, pranë rrugës që të çon në Klenjë.

Situated near the village Librazhd Katund in the district of Librazhdit, 1000 m above sea level. It represents a separate maple tree. Maple is about 10 m high, has 17 branches and crown circumference of 16 m. The trunk circumference is 180 cm, while its diameter is approximately 65 cm. There are 140 years of age. It has a beautiful crown and the tree is well preserved by the residents. Next to it are always men of the village that gather for important meetings and conventions. There is scientific value (biological), didactic, aesthetic, cultural. It can be visited by the rural road Librazhd- Librazhd Katund, near the road that leads to Klenje.



■ *Mani Çupit / Cup Mulberry*

Gjendet në qendër të fshatit Orenjë, përfaqëson një dru mani të veçuar. Lartësia e drurit është 6m, diametri i trungut është 120cm, ndërsa diametri i tij rreth 400cm. Perimetri i kurorës është 40m dhe ka 24 degë. Moshë e manit është 220 vjeçare. Ka vlera shkencore (biologjike), historike e kulturore. Nën kurorën e tij janë mbledhur banorët e fshatit për takime, kuvende, etj.

Vizitohet sipas rrugës rurale Librazhd – Orenjë

Found in the middle of the Orenjë village, the mulberry represents a separate tree. The height of the tree is 6 m, trunk diameter is 120 cm, while its diameter of 400 cm. Crown perimeter is 40 m and has 24 branches. Mulberry age is 220 years. There is scientific value (biological), historical and cultural. Under his crown villagers have gathered for meetings, conventions, etc. Visited by rural road shines -



■ *Rrapi Hotolishtit / Hotolisht maple*



Ndodhet në fshatin Hotolisht- Librazhd. Lartësia e drurit arrin rreth 700m mbi niveli e detit. Pema ka një lartësia mesatare 28 m, diameter:200 cm,dhe moshë 150 vjecare. Gjëndja e këtij monamenti është e mirë.

Vlera historike: Pranë këtij Rrapi janë mbledhur gjithmonë banorët e fshatit për takime diskutime etj, Rruga nëpërmjet të cilës mund të arrihet në destinacion: Rruga auto Librazhd-Hotolisht me gjatesi rreth 12 km , deri tek monamenti i natyres.

Situated in Hotolisht Village. The tree height is about 700 m above sea level. The tree has an average of 28m, diameter of 200 cm, 150 years old. This monument is in good conditions.

Historical value: Near this plane have always been village gatherings for meetings and discussions. The way till there can be reached by the local road Librazhd-Hotolisht with a length of 12 km, till the national monument.

■ Parku Kombëtar Shebenik-Jabllanicë

Parku Kombëtar Shebenik-Jabllanicë shtrihet në pjesën lindore të rajonit të Librazhdit dhe përfshin malet me të njëjtin emër që e kufizojnë me Maqedoninë. Ai ka një shtrirje më të madhe se 30 km nga fshati Steblevë në Veri të tij dhe deri në Rajca, fshat në pjesën jugore duke zënë një sipërfaqe prej 33,929 hektarë. Përsa u përket vlerave ekologjike mund të themi se janë të shumta, si flora e fauna, ashtu edhe peisazhet turistike.

- Rrjeti hidrografik

Vlera të veçanta ka hidrografia, me lumenjë, përrrenjë, liqene artificialë, burime (gurra) dhe pellgje ujore karstike. Brenda parkut gjenden mbi 14 liqene akullnajore të vegjël me bukuri madhështore, të cilët ndodhen në një lartësi mbi 1900 metra mbi nivelin e detit. Janë gjithashtu dy lumenj që rrjedhin përmes zonës së Parkut me një gjatësi prej 22 km, përfshirë në veri lumin e Qarrishtës që bashkohet me lumin Rrapun dhe në jug lumin e Bushtricës që bashkohet me lumin Shkumbin.



- Klima

Klima në shumicën e parkut bie në kategorinë e klimës mesdhetare, me temperatura mesatare vjetore ndërmjet 7 ° C dhe 10 ° C. Reshjet mesatare vjetore janë midis 1.300 mm dhe 1.800 mm.

- Fauna

Fauna është shumë e pasur, speciet kryesore të faunës janë: ariu i murrmë, ujku, vjedulla, dhelpra, ketri, nusja e lalës, shqiponja, skifteri. Më të rrallë janë: zardafi, derri i egër, kaprolli, dhia e egër, rrëqebulli, gjeli i egër, trofta e malit.

Parku Kombëtar Shebenik-Jabllanicë konsiderohet që të jetë një nga qendrat kryesore për rrëqebullin e Ballkanit, lloj i kërcënuar.

- Flora

Parku ka drurë ahu, pishë e zezë, bredh, lis, mështekna, arneni, bush, ajdes, panjë, shelg, lajthi, shkozë, mëllezë, vidh, vodhëz të egër, qershi të egër, boronicë, gorricë, dardha të egër, trëndafil të egër, çaji i mali, sanza dhe më i rralli, endemiku ylli i alpeve. Është e rëndësishme që të përmendim faktin se në zonat e larta malore konstatohet prania e bimëve të rralla dhe të rëndësishme si: *Cystus albanicus*- trendafil shqiptar i gurit (lloj endemik), *Genista hassertiana*- gjineshtra (lloj subendemik), *Viola albanica*- viola shqiptare (lloj subendemik), *Viola ducadjinica*- viola e Dukagjinit (lloj subendemik), *Heliosperma pusilla* subsp. *Candavica*- grivella e gurit (lloj subendemik), etj.

Parku Kombëtar Shebenik-Jabllanicë përveç vlerave të shumta faunistike, të ofron dhe një sfond mjaft relaksues e clodhje për të gjithë familjen dhe jo vetëm, një park që ofronë bukuritë e tij në të gjitha stinët e vitit. Parku është një mundësi e shkëlqyer për të kaluar pushimet, një fundjavë të këndshme, mund të kryeni guida malore, ski, ecje në natyrë, alpinizëm etj. Kjo arrihet duke udhëtuar vetëm 20 km nga qyteti i Librazhdit.



■ **Shebenik-Jablanica National Park**

Shebenik-Jablanica National Park is located in the eastern part of Librazhdi district and included the previously mentioned mountains bordering with Macedonia. It spans for more than 30 kilometres from the village Stebleva in the North to Rrajca in the South and covers an area of 33,929 hectares. As for the ecological values, we can say that there are numerous, flora and fauna, as well as tourist landscapes.

- Hidrographic network

Special value has hydrography, with rivers, streams, artificial lakes, fountains and karst water ponds. Inside the park there are over 14 small glacial lakes of great beauty, which are situated at an altitude of 1900 meters above sea level. There are also two rivers that flow through the park area with a length of 22 km, including in the north River of Qarrishta joined by Rrapun River and in the south river Bushtica joined by river Shkumbin.

- Climate

The climate of most of the park falls into the category of the Mediterranean climate, with average annual temperatures between 7 ° C and 10 ° C. The average annual precipitation is between 1,300 mm and 1,800 mm.

- Fauna

Fauna is very rich, the main species of fauna are: the brown bear, wolf, badger, fox, squirrel, weasels, eagles, falcons. More rare are: beaver, wild boar, roe deer, chamois, lynx, grouse, mountain trout. National Park Shebenik- Jablanica is considered to be one of the main centers for the Balkan lynx, an endangered species.



- Flora

The park has beech trees, black pine, spruce, oak, birch, pine, bush, maple, willow, hazelnut, hornbeam, steal, wild fruit, wild cherry, blueberry, Gorica, wild pears, rose wild, mountain tea, Sanzais one of the rarest, the endemic star of the Alps. It is important to mention the fact that in high mountain areas there are rare and important plants as Cystusalbanicus- Albanian pink stone (endemic species), Genistahassertiana- broom (kind subendemic), Viola albanica- Albanian viola (sort subendemic), Viola violaducadjinica- Dukagjin (sort subendemic), Heliospermapusilla subsp. Candavica- grivella Stone (type subendemic), etc.

The National Park Shebenik- Jablanic apart, the numerous values in fauna, it offers a very relaxing background of recreational value for the whole family and not just a park that offers its beauties in all seasons of the year. The park is an excellent opportunity to spend the holidays, a nice weekend, you can do mountain guides, skiing, hiking, mountaineering etc. This is achieved by traveling only 20 km from the town of Librazhd.

Mali i Polisit

Ndodhet rreth 80 km nga Tirana, është midis Elbasanit dhe Librazhdit në vendin e quajtur Mirake, kalon lumin Shkumbin dhe ngjitesh djathtas për 15 km. Ka bimësi të shumëllojshme e cila është një atraksion për biologë të ndryshëm. Për 6 muaj të vitit është e mbuluar nga dëbora. Në të mund të zhvillohet turizmi dimëror, sporte të ndryshme dimërore, hipizëm, ski, etj.



Polis Mountain located about 80 km from Tirana, is between Elbasan and Librazhd place called Mirake passes and climb right Shkumbin River for 15 km. There is diverse vegetation which is a different attraction for biologists. 6 months of the year is covered by snow. There can be developed winter tourism, winter sports, horseback riding, skiing, etc.



■ *Ahet e Fushë Gurrës / Gurra Field Beeches*

Gjendet në afërsi të fshatit Gurrë të Librazhdit, 1300 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson një pyll ahu, me sipërfaqe rreth 50 ha. Lartësia e drurëve është 20 – 30 m, diametri i trungut është 50 – 80 cm, perimetri trungjeve është 150 – 200 cm, ndërsa mosha e tyre është 100 vjeçare. Ende ruhet në gjëndje të mirë. Ka vlera shkencore (biologjike), didaktike, estetike e turistike. Vizitohet sipas intinerarit: Librazhd – Gurrë

Found near Gurre village of Librazhd, 1300 m above sea level. It represents a beech forest, with an area of about 50 ha. The height of the trees is 20-30 m, trunk diameter is 50-80 cm in circumference trunks 150-200 cm, while their age is 100 years. Still preserved in good condition. There is scientific value (biological), didactic, aesthetic and tourism value. Visited by Librazhd - Gurrë itinerary.



■ *Pylli i Barkmadhit Kostenje / Paunchy Forest Kostenje*

Gjendet në afërsi të fshatit Kostenjë të malësisë së Çermenikës, 1200 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson një pyll të përzierë ahu dhe fletorë të tjerë, ndër të cilët në pjesën e poshtme shfaqet edhe dushku. Lartësia e drurëve është 15 – 30 m, diametri i trungut është 50 – 60 cm, perimetri trungjeve është 70 - 90 cm, ndërsa mosha e tyre është 90 vjeçare. Ende ruhet në gjëndje të mirë. Ka vlera shkencore (biologjike), didaktike, estetike e turistike. Vizitohet sipas intinerarit: Librazhd – Kostenjë – monumenti.

Near Kostenje village is found in the highlands of Çermenikës, 1200 m above sea level. It represents a mixed forest of beech and other timber, among them downstream oaks appear. The height of the trees is 15-30 m, trunk diameter is 50-60 cm in circumference trunks 70-90 cm, while their age is 90 years. Still preserved in good condition. There is scientific value (biological), didactic, aesthetic and tourism. Visited by Librazhd - Kostenjë itinerary- monument.



■ Shpella e Plakes Gizavesh / *Cave of the Old lady, Gizavesh*

Në fshatin Gizavesh ndodhet një shpellë që njihet me emrin "Shpella e Plakës". Sepse mendohet dhe thuhet se në të ka jetuar një plakë. Kjo shpellë shumë vite më parë mendohet se lidhte dy fshatrat Gizavesh dhe Librazhd Katund, por tani kjo rrugë është e bllokuar. Në hyrje të kësaj shpelle ndodhet një burim uji. Në shpellë ka gurë të veçantë të cilët shkëlqejnë. Për ta vizituar këtë shpellë duhet një mjet ndricimi për arsye se është vështirë për tu kaluar.



In Gizavesh Village there is a cave known with the name “Cave of the Old lady”. Because it is thought and said that there have lived an old lady. Many years ago, it was thought that this cave connected two villages, Gizavesh and Librazhd Katund, but now this road is blloked. In the entrance there is a water spring. In the cave there are special stones that sparkle. To visit the cave there is needed a light network because its hard to pass through.

■ *Seria e Kuqërremtë Librazhd / Reddish Series Librazhd*

Në Luginën e Shkumbinit, në rrugën Librazhd-Përrenjas, dalin në sipërfaqe depozitime potente të Pliocenit. Ato janë formime kontinentale, liqenore, të formuara në një ambient të cekët, me shpate të pjerrëta, gjatë një periudhe me klimë të nxehtë dhe të thatë. Ato përfaqësohen nga konglomerate, ranorë, alevrolite, argjilaalevrolitike etj. Për nga ngjyra e tyre e kuqe janë emërtuar “Seria e kuqërremtë e Librazhdit”. Ky është një fenomen i veçantë, i përhapur kryesisht në këtë pellg, mbi sipërfaqen e masivit ultrabazik të Shebenikut. Vërehen tekstura dhe figura të shumta sedimentimi, si dhe shpesh piramida erozionale. Kjo seri përbën një gjeomonument paleoambiental me vlera shkencore, didaktike dhe gjeoturistike.

Shkumbin Valley, on Librazhd- Pwrrenjas road, there emerge potent Pliocene deposits. They are continental formations, lake, formed in a shallow environment, with steep slopes, during a long period of hot and dry climate. They are represented by conglomerates, sandstones, silts, clays etc. For by their red color are labeled "reddish Series Librazhdi ". This is a unique phenomenon, spread mainly in the pond, on the surface of the ultra-basic Shebenik massif. Observed textures and numerous pictures of sedimentation, and often erozion pyramid. This series is a geomonument paleo-environmental with scientific, didactic and geoturistic values.



Traseja e rruges Egnatia



Rruga “Egnatia”, e cila njihet dhe si “Via Egnatia”, është një nga rrugët më të mëdha e më të rëndësishme të botës antike. Është ndërtuar diku në mesin e viteve 149-120 p.e.s nga Prokonsulli romak i Maqedonisë Gnaeus Egnatius, mbi gjurmët e një rruge e cila sipas Aristotelit lidhte bregdetin e Adriatikut me viset e Maqedonisë dhe Trakisë, Perëndimin me Lindjen, Romën me Konstandinopojën.

Rruga Egnatia ka njohur tregti, beteja historike, predikues të kryqit, religjione romane dhe otomane.

Kjo rrugë ruhet ende, gati e paprekur, përgjatë gjithë rrjedhës së sipërme të lumit të Shkumbinit, veçanërisht në trevat e malësisë së Librazhdit, nga Miraka e deri në Qukës. Në të gjithë gjatësinë e kësaj rruge ndodhen një numër monumentesh të rëndësishme arkeologjike e kulturore.



Vizitorët që do të shtegtojnë nëpër trasenë e rrugës së vjetër “Egnatia” do te ecin në gjurmët e historisë, duke njohur dhe vizituar fragmentet e rrugës më të vjetër dhe më të famshme të botës antike.

Egnatia road route



Street Egnatia, which is also known as “Via Egnatia”, is one of the most important roads of the ancient world. It was built in between the years 149-120 B.C. by the Roman proconsul of Macedonia, Gnaeus Egnatius on the trail of a road which according to Aristotle connected the Adriatic coast regions with Macedonia and Thrace areas, West with East, Roma with Constantinople.

Via Egnatia has known trade, historical battles, church preachers, Roman and Ottoman religions.

This road is still kept untouched, throughout the upstream of Shkumbin river, particularly in mountainous areas of Librazhd from Miraka to Qukes.



Visitors are going to walk through the old Egnatia road, in the pathway of history, by learning and visiting fragments of the most old and famous old in ancient times

■ Ura e Kamares / Kamara bridge

E vetmja, mes dhjetra veprave të tilla përgjatë rrjedhjes së lumit të Shkumbinit, ura e Kamares në Mirakë të rrethit të Librazhdit , ende qëlon mbi dallgë nga largësitë e pesë shekujve. Objekti, që është deklaruar "**Monument culture**" ndodhet rreth 20 kilometra në Verilindje të Elbasanit, 5 kilometra, pa arritur në qytetin e Librazhdit, direkt mbi shtratin e lumit të Shkumbinit. Vetë etimologjia e fjalës ura e Kamares të lë të kuptosh që një emër i tillë i ka mbetur nga e folura krahinore që në vend të fjalës dritare, ende përdorin fjalën sinonimizuese kamare.

Për nga struktura ndërtuese, ura në fjalë na parqitet me pesë kamare hapsira drita, të cilat nuk janë secila të barabarta, por në funksion të relievit mbi lumë dhe llogaritjes së forcës goditëse të dallgëve të lumit. E vendosur mbi pesë qemerë, ndërtuar me gurë ngjyrë gri në të bardhë si vetë përbërja gurore e malit të Murrashit, bazamenti për kalimtarë është ndërtuar me një kalldrëm me gurë lumi të rrumbullakët, vendosur horizontalisht me lëvizjen e udhëtarëve.

Kjo urë u ndërtua në 1715 nga Ahmeti nga Elbasani, sipas mbishkrimit turqisht në pllakën e gurit të Kamarës, e cila sot ruhet në muzeun e Librazhdit.



The only among dozens of such works along the flow of the river Shkumbin, bridge of kamara in Mirake. The object, which was declared "**Cultural monument**" is located about 20 kilometers northeast of Elbasan, 5 kilometers before reaching the town of Librazhd, directly on the Shkumbin river bed. The very etymology of the word Kamara bridge implies that such a name has remained by the local spoken language that for the word window, they would still use the other synonym word.

In terms of building structures, this bridge has through the way five windows with space lights, which are not equal with one another, but in view of relief over the river and calculating the striking force of the waves of the river. Located on five vault, built of gray stones in the quarry itself as white composition of mountain of Murrash, the basis for pedestrians path is built by round stones river, placed horizontally with the movement of passengers.

This bridge was built in 1715 by Ahmad from Elbasan, according to the inscription on the plaque of Turkish stone in the bridge, which is now preserved in the museum of Librazhd.

■ Fusha karstike e Studnës / Studen Karst Field

Fusha karstike e Studnës ndodhet në lartësinë rreth 1100m mbi nivelin e detit dhe ka një sip. Prej 5.6km². Ajo rrethohet nga të gjitha anët me male, duke përbërë një formim karstik tipik në formën e një ulluku sinklinal. Konsiderohet një fushë tektono-karstike, e formuar nga ujërat nëntokësore që kanë qarkulluar dhe qarkullojnë në bazament dhe ndërtohet nga gëlqerorë pllakorë të Triasikut. Vetëm në skajin verilindor dalin formacione flishore, kurse në qendër ruhen mbetjet erozionale të konglomerateve e rreshpeve argjilo-ranore. Ajo nuk ka rrjedhje sipërfaqësore sepse është e mbyllur. Faqet e gropës karstike të Studnës janë të pyllëzuara me ahe, bredh, pishë, çfarë i jep edhe vlera turistike. Në veriperëndim ngrihet Maja e Gurit, 1825m e lartë.

Studen karst field at a height of about 1100m above sea level and has an area of 5.6 km². It is surrounded by mountains, making up a typical karst formation in the form of a syncline groove. Considered a tektono-karst area formed by groundwater that circulated and circulated in the plinth and built by Triassic limestone plates.

Only at the northeastern part there emerges flysch formations, whereas in the center there are saved remains of the conglomerate's erosion and slate clay-sand. It was no surface runoff, because it is closed.

The sides of the Karst pit are forested with beech, fir, pine, that gives the touristic value. At northwest there is Stone Top (maja e gurit), 1825m high, also full of karst forms on the surface; out of most important is Prevall Field.



■ Fusha karstike e Qarrishtës / Karst Field of Qarrishta

Kjo fushë përfaqëson zonën ku vendoset fshati me të njëjtin emër. Ajo ka shtrirje 2-3km dhe gjerësi 800-1000m. Trashësia e depozitimeve në fushë arrin 3-5m. Nga pikëpamja gjeologjike ajo përfaqëson kontaktin midis shëmbinjve ultrabazikë dhe gëlqerorëve të Triasit. Në veri të fshatit Qarrishtë, pasi mbaron Mali i Qarrishtës, 500-600m, takohen dy gropa karstike me sipërfaqe 50x50m dhe thellësi 25-30m. Të dyja gropat kanë pjerrësi anësore 50-60°. Në periudhën tetor-maj këto gropa janë të mbushura me ujë. Peisazhi është mjaft tërheqës. Ajo ka vlera gjeologjike, turistike dhe klimaterike.



This area represents the area where is placed the village with same name. It has 2-3km stretch and width 800-1000m. The thickness of the deposits in the field reaches 3-5m. Geologically it represents the contact between ultrabasic rocks and triasit limestone. In the north of Qarrisht village, after Qarrishta Mountain ends, 500-600m north, there are meet two karst pits with 50x50m area and depth of 25-30m. Both pits have a sloping side 50-60°. In the period from October to May these pits are filled with water. The landscape is quite attractive. It has geological values, tourism and climate.

■ *Fusha Karstike e Mirakës / Karst Field of Miraka*

Mali i Mirakës (1751m) shtrihet në verilindje të Malësisë së Çermenikës dhe ndërtohet nga shkëmbinj karbonatikë të T3J1. Aty dominon peizazhi karstik me hinka, gropa, uvalla, sidomos në sektorët me forma të buta të relievit. Ndër format karstike tipike dallohen: Fusha e Letmit (rreth 50ha), Fusha e Poshtme me gjatësi 1300m (një uvallë tipike) dhe Fusha e Mirakës (1751m lartësi).



Miraka Mountain (1751m) lies to the northeast of Çermenika Mountains and built out of carbonate rocks T3J1. It dominates the karst landscape with funnels, pits, “uvalla”, especially in sectors with soft relief forms. Among the typical karst forms there are distinguished: LetmiField (about 50ha), Lower Field with 1300m length (a typical uvallë) and fields higher up (1751m altitude).

■ *Ura e Gurit / Stone bridge*

Kjo urë ndodhet midis fshatit Polis dhe Fushe-Buall në zonën e quajtur Gostime. Stili i saj është tipik mesjetarë, punime guri me harrqe, me gëlqerë dhe elementë të tjerë që i rrisin fortësinë.

This bridge is located between the village of Polis and Fushe-Buall area called Gostime. Its style is typical medieval stonework with arcs, with lime and other element, raising the hardness.




■ *Pusi i Fages së Madhe / Well of the Big Site*

Ky pus ndodhet në afërsi të fshatit Dardhë e Malit, në lartësinë 1750m mbi nivelin e detit. Ai përbën një shpellë vertikale (pus) karstike, e formuar në shkëmbinjtë gëlqerorë të Kretës së sipërme, është i thellë rreth 62m dhe në fund mbyllet me një masë akulli. Ka vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, biologjike), kulturore, didaktike dhe turistike. Vizitohen sipas itinerarit Librazhd – Dardhë e Malit..

This well is located near the village Dardhe e Malit, up to 1750m above sea level. It is a vertical cave (well) karst, formed in the upper Crete limestone cliffs, with depth about 62m and finally closed with a mass of ice. There is scientific value (geological, geomorphological, hydrological, biological), cultural, touristic and didactic. Visited by Librazhd- Dardhe e Malit itinerary - monument.



Shkëmbi i Draganit



Qafë Shapka



Maja e Katrafilit



Fshati Llange



Zalli i Boroves



Stebleve



Liqeni Fushe-Studnes



Guri i Skenderbeut Spathar